



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Pimljen / Prodato Received / Delivery	15.05.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKMSHOK	4242/2023		112



## Republika e Kosovës

### Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.624/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.624/2023 të datës 07.04.2023, kundër organit të punësimit Komunws sw Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.05.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.624/2023 të datës 07.04.2023, të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi më datë 07.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës par Shërbimin Civil, kundër njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare të vlerësimit të datës 14.03.2023, lidhur me me pozitën Zyrtar për shërbim me qytetar, për emrin e grupit Specialistë të Administrimit të Përgjithshëm, e shpallur nga Komuna e Prizrenit sipas Konkursit numer reference RN00010357. Ndërsa, me datë 25.04.2023 ankuesi ka parashtruar kërkesën me numër protokoll 3803/2023 për tërheqjen e ankesës së datës 07.04.2023.

Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës me numër protokoll 3803/2023, e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 103 paragrafit 1 ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.624/2023 të datës 07.04.2023.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.




**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit është i paligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.624/2023.

Ardita Perguku-Shyti

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

